



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 44 paragrafi 40.2 nën c) të LVL nr.03/L-040 dhe nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 Për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në raste të Jashtëzakonshme -me rastin e Pandemis- Coronavirusit, si dhe nenit 30 të Ligjit nr.03/L-148 mbi menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjesit, nenin 15 të ligjit nr.07/L-001 Mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 Udhëzimit Administrativ MF-05/2019 Për procedurat e transferit dhe rialokimit dhe sipas Qarkores Ligjore Për zbatimin e vendimeve të Qeverisë Për Parandalimin e Virusit COVID-19 dhe me kërkesen e 1/3 të anëtareve të Kuvendit të Komunës së Klinës të datës 29.04.2020, Kryesuesi i Kuvendit thirrret Seancë e Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Klinës e cila seancë mbahet në formë elektronike me datën 06.05.2020 gjërë në orën 16:00, me paraqitjen Pro të 25 anëtareve të Kuvendit dhe 1 , miratohet ky:

V E N D I M

Për

Ndarjen dhe Transferin e mjeteve prej 90,000.00€

1. Miratohet ndarja dhe transferi i mjeteve në shumë prej 90,000.00€ me qëllim të ndihmes ekonomike të familjeve me nevojë si dhe nevojave tjera për menaxhimin e vazhdueshëm të situatës për parandalimin e virusit COVID-19
2. Nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime fondi burimor 10
 - 2.1. Nga programi Buxhet e financa (175) , nen-programi Buxhetimi (17518) , kodi funksional (0112) nga kategoria mallra dhe shërbime shuma 18,000.00 € .
 - 2.2. Nga programi Shërbimet publike mbrojtja civile (180), nen-programi Infrastruktura rrugore , kodi funksional (0451) nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve shuma 23,000.00 € .
 - 2.3. Nga programi Arsimi dhe shkenca (920), nenprogrami Administrata (92090) , kodi funksional (0980) nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve shuma 14,000.00 € .
 - 2.4. Në programin Shërbimet Publike Mbrojtja Civile (180) nën-programi Infrastruktura rrugore(18018) , kodi funksional (0451) në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime,kodi i projektit 00099-Shpenzimet për menaxhimin e emergjencës nga COVID-19 , shuma prej 55,000.00 €.

3. Nga kategoria ekonomike shpenzime kapitale fondi burimor 10

Nga programi Shërbimet Publike Mbrojtja Civile (180) nën-programi Infrastruktura rrugore (18018), kodi funksional (0451) nga kategoria e kapitaleve , projekti Rregullimi i rrjetit të kanalizimit kodi 49586 shuma 5,000.00 € .

4. Nga kategoria ekonomike shpenzime kapitale fondi burimor 21

4.1. Nga programi Planifikimi urban dhe mjedisi (660), nën-programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66395), kodi funksional (0620) nga kategoria ekonomike shpenzime kapitale-Projekti Bashkëfinancim me donatorë ,kodi 48267 shuma 30,000.00 €

4.2. Në programin Shërbimet Publike Mbrojtja Civile (180) nën-programi Infrastruktura rrugore (18018), kodi funksional (0451) në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime,kodi i projektit 00099-Shpenzimet për menaxhimin e emergjencës nga COVID-19 , shuma prej 35,000.00 € .

5.1. Ndarja e këtyre mjeteve kërkohet bazuar në nevojat e e menagjimit te gjendjes emergjente në Komunën e Klinës për shpenzimet lidhur me përballimin e kërkesave që dalin lidhur me përballjen me pasojat e COVID-19 dhe me qëllim të marrjes se masave të domosdoshme për luftimin e këtij virusi dhe pasojave të tij në komunën e Klinës.

5.2.Këto mjete do të shfrytëzohen dhe shpenzohen për plotësimin e nevojave Immediate si rezultat i paraqitjes dhe situatës se krijuar nga COVID-19 dhe në bazë të vlerësimit të gjendjes nga ana e Grupit punues për gatishmëri emergjente të Komunës se Klinës, si për qytetarët edhe institucionet publike të komunës.

6.Vendimi ekzekutohët nga Drejtorija e Financave, Ekonomi dhe Zhvillim në kordinim me Ministrinë e Financave dhe Kryetarin e Komunës.

7. Vendimi është i plotëfuqishem me miratim nga Kuvendi i Komunës dhe 7 ditë pas publikimit në ëeb faqe të Komunës konform Rregullores (QRK) nr.10/2019 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (shtojca II).

Me këtë vendim të njftohën: MAPL, MF, Kryetari i Komunës, Drejtorija e Financave, Ekonomi dhe Zhvillim, Sherbimi për Punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr./zyrtar-3 /2020
Klinë, me dt.06.05./2020



Kryesuesi,
Fadil Gashi